



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 69, Datë 12.04.2024

MBI

**DHËNIEN E GARANCISË SË ORIGJINËS PËR ENERGJINË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA HEC “SHKOPET”, I SHOQËRISË “KURUM INTERNATIONAL”
SH.A., PËR VITIN 2023**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 7 dhe 11 të Rregullores për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, miratuar nga bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar; nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 109/10 prot., datë 09.04.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi dhënie e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga nga Hec “Ulëz”, “Shkopet”, “Bistrica 1” dhe “Bistrica 2”, të shoqërisë “Kurum International” sh.a., për vitin 2023”,

Konstatoi se:

- Me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 109 prot, datë 10.01.2024, shoqëria “KURUM INTERNATIONAL” sh.a. ka paraqitur kërkesën për lëshimin e garancisë së origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga HEC “Shkopet” për vitin 2023.
- ERE me shkresën nr. 109/2 prot., datë 10.01.2024, i ka evidentuar shoqërisë dhe dokumentacionin e munguar të aplikimit.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 109/3 prot., datë 23.02.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit, nga shqyrtimi i të cilit rezultoi se kishte ende informacion/dokumentacion të paplotësuar, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 109/5 prot., datë 21.03.2024.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 109/7 prot., datë 28.03.2024 dhe e-mailin e protokolluar me nr. 109/10 prot., datë 05.04.2024, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacionin e munguar të këtij aplikimi.
- Si në rastet e mëparshme analoge dhe mbështetur në përcaktimet e nenit 22, pikës 6 të ligjit nr. 24/2023, me shkresën nr. 109/4 prot., datë 11.03.2024, ERE i është drejtuar OST sh.a. me kërkesën për informacion për sasinë e energjisë elektrike faktike të prodhuar nga këto hidrocentrale për secilin muaj të vitit 2023, si dhe kodin/numrin e matësit/matësve.
- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 109/6 prot., datë 25.03.2024, OST sh.a. ka paraqitur të dhënat për numrin serial të matësve, si dhe informacion në formë tabelare për energjinë e prodhuar nga HEC “Shkopet” për secilin muaj dhe sasinë totale vjetore, duke bërë me dije se për këto dy HEC-e energjia elektrike matet në të njëjtat pika matjeje.
- Nga analizimi i aplikimit rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për lëshimin, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 229, datë 20.12.2019, e ndryshuar.
- Për sa më sipër, vlerësohet dhënia e Garancisë së Origjinës për energjinë e prodhuar nga HEC “Shkopet” për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, sipas sasive të dhëna nga OST sh.a.
- Në zbatim të përcaktimeve të nenit 22, pikës 5 të ligjit nr. 24/2023, *Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e Garancisë së Origjinës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Shkopet” i shoqërisë “KURUM INTERNATIONAL” sh.a., për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Garancia e origjinës, e dhënë sipas përcaktimeve të këtij vendimi, është e vlefshme për 1 (një) vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE NË DETYRË

Erjola SADUSHI

Prodhimi mujor (MWh) /HEC	HEC “Shkopet”
<i>Janar</i>	12113
<i>Shkurt</i>	11439
<i>Mars</i>	8896
<i>Prill</i>	8434
<i>Maj</i>	13203
<i>Qershor</i>	5879
<i>Korrik</i>	5945
<i>Gusht</i>	0
<i>Shtator</i>	0
<i>Tetor</i>	0
<i>Nëntor</i>	0
<i>Dhjetor</i>	4174
<i>Totali</i>	70083